



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

№: 145 Nr. Dokumenti: 2160/18
Data: / Data: 25.09.18

Prishtine 7.0

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

DATE/A:	19.04.2018
REFERENC-Ë:	Procesverbal për inspektimin e kryer nr.18/24-INS-PV-03-LB, datë 16.04.2017
PËR/ZA/TO:	Gjykata Themelore Pejë, dega Istog Departamenti i Përgjithshëm Divizioni për kundërvajtje
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër [REDACTED]

Të nderuar

Bashkangjitur gjeni kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje nga inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ,kundër operatorit [REDACTED] me aktivitet " Shfrytëzim dhe seperim i gurit gëlqeror në lokacionin Vrellë , komuna e Istogut .

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

GJYKATA THEMELORE PEJË

Dega Istog

Departamenti i Përgjithshëm

Në bazë të nenit 86 të Ligjit për kundërvajtje nr.05/L-087 (GZRK Nr.33/2016) , nenit 81,82,83 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit nr 03/L-025 (Gazeta Zyrtare Nr.50/2009).Nenit 7 ,34,35,36 të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis Nr.03/L-214.Nenit 62,63,65 të Ligjit për mbeturina nr.04/L-060.Nenit 10,22,23,24 të Ligjit për Inspektoratin e mjedisit, ujërave ,natyrës ,planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr 04/L-175. Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit paraqet këtë :

Kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes

Kundër:

1. [REDACTED]
person juridik
2. [REDACTED] person përgjegjës

Për shkak :

Të mos veprimi sipas kërkesës,përkatësisht mos zbatimit të urdhërësës dhe afatit të caktuar nga inspektori,sipas detyrimeve ligjore për subjektin mbikëqyrës nga neni 27 paragrafi 1 dhe 1.1 e sanksionuar me dispozita kundërvajtëse sipas nenit 49 paragrafit 1 dhe nënparagrafit 1.1 për mos veprim sipas kërkesës dhe afatit të caktuar me urdhër të inspektorit sipas Ligjit për inspektoratin e mjedisit, ujërave , natyrës ,planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr 04/L-175 ,përkatësisht urdhërësës së dhënë në afat prej 30 ditëve në lidhje me detyrimet ligjore për operatorin për rehabilitimin e terenit, përkatësisht mbulimin dhe rafshimin e gropimeve të mëdha të krijuara gjatë viteve nga aktiviteti i eksploatimit të gurit në lokacionin e Vrellës nga operatori [REDAKTUAR]

Arsyetim

Me datë 16.04.2018, ekipi i inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës të MMPH-së, Luan Badivuku, Ismet Dërvari dhe Vehbi Spahiu,ka ushtruar kontrolle dhe mbikëqyrje inspektuese të aktivitetit të operatorit [REDAKTUAR], me aktivitet të shfrytëzimit,thërmimit dhe seperimit të gurit në hapsirën mbi fshatin Vrellë të quajtur Lugu i Madh, sipas kërkesës së udhëheqësit të inspektoratit dhe ankesat e shqetësimet e vazhdueshme të banorëve të fshatit të Vrellës për sigurin e familjeve të tyre dhe bagëtime për gropimet e thella të krijuara nga eksploatimi, nga operatori [REDAKTUAR] dhe operatorë tjerë dhe gjendjen e këtyre gropimeve që janë me rrezik potencial për ndonjë aksident .

Me rastin e inspektimit të terenit, u konstatua se gjendja ne teren është e rëndë dhe jo e mirë, për shkak të gropimeve të krijuara nga operatori [REDAKTUAR] dhe operator të tjerë, të cilat gropime paraqesin rrezik potencial për ndonjë aksident për njerëz apo bagëti për banorët e fshatit Vrellë i cili gjendet në afërsi të gropimeve ,duke marrë parasyshtë gjendjen e rëndë nga gropimet e thella të krijuara dhe të mbuluara me ujë si nga të rreshurat atmosferike ashtu edhe nga seperimi dhe shpërlarja e gurëve nga seperacioni i operatorit [REDAKTUAR]

Operatorit [REDAKTUAR],nga inspektimi i datës 26.09.2017 i është tërheq vërejtja dhe i është dhënë urdhëresa me procesverbal 17/24-INS-PV-LB-63,për mbulimin dhe rehabilitimin e gropimeve, gjë që operatori [REDAKTUAR] nuk e ka kryer, por vetëm me disa punë fillestare të ndërtimit të terasave-kaskadave e që pas ndërtimit të tyre do të filloj mbushjen e terenit me dhe ,respektivuisht do të filloj me mbulimin e gropave të krijuara gjatë aktivitetit të tyre.

Nga konstatimi i gjendjes dhe rrezikut potencial për ndonjë aksident me pasoja për njerëz apo bagëti të banorëve të fshatit Vrellë, operatorit në fjalë i është dhënë urdhëresa që në afat prej 30 ditëve me procesverbal të datës 28.09.2016, të paraqes planin me shkrim për rehabilitimin e terenit dhe të njejtin plan ta paraqet MMPH-së për aprovim.

Operatori [REDAKTUAR] përkatësisht, personi përgjegjës [REDAKTUAR] deri më sot nuk ka zbatuar masën e urdhërësës dhe afatit të caktuar prej 30 ditëve , për mbulimin e gropave dhe rehabilitimin e terenit si dhe vendosjen e rrethojës në fushën eksploatuese ,bazuar

nga kushti i Lejes Mjedisore dhe Pëlqimit Mjedisor gjë që ky veprim i mos zbatimit të obligimeve ligjore paraqet shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit nr.04/L-175,e sanksionuar me dispozita sanksionuese për kundërvajtje për mos veprim sipas urdhëresës sipas Ligjit për Inspektoratin e mjedisit, ujërave , natyrës ,planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr 04/L-175, (detyrimet për zbatim sipas nenit 27 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.1 e sanksionuar me dispozitat ndëshkuese për mos zbatim nga neni 49 paragrafit 1 dhe nënparagrafit 1.1 i këtij ligji).

Andaj operatori në fjalë [redacted] përkatësisht personi përgjegjës [redacted] janë përgjegjës për shkelje ligjore të dispozitave ligjore të lartëcekura për mos veprim sipas urdhërit dhe afatit të caktuar nga inspektori, dhe të njejtit duhet sanksionuar sipas dispozitave ligjore në fuqi .

Prishtinë : 19.04.2018

Inpektorati për Mbrojtjen e Mjedisit dhe natyrës

Luan Badivuku

Ismet Dërvari

Vehbi Spahiu

Bashkangjitur provat :

Kopja e Procesverbalit

Foto nga tereni